

22/02/2024

02/103



Komuna Shtime

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E SHTIMES / OPŠTINA ŠTIMLJE
Nr i Prot./Dr. Prot.	02/132
Nr i Faqeve/Bir.strana	
Data/Osna:	22.02.2024
SHTIME / ŠTIMLJE	



flutura
academy

Në mbështetje të nenit 6 (paragafi 1, nënparagafi 1.3) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe duke u bazuar në Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim më Pak se një vit Pronën e Paluajtshme të Komunës së Shtimës, sipas Rekomandimit të dhënë nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Marrjen e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim me nr. 02/73 të datës 08.02.2024, Kryetari i Komunës së Shtimes bashkë me Flutura Academy Sh.P.K lidhin këtë:

Marrëveshje bashkëpunimi

Për dhënien në shfrytëzim për një periudhë për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme – saktësisht për 11 muaj Qendrën e Inovacionit në kuadër të Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) të Komunës së Shtimes.

PALËT NË MARRËVESHE

- KRYETARI I KOMUNËS I CILI E PËRFAQËSON KOMUNËN E SHTIMES**, në mbështetje të Rekomandimit të Komisionit si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë
dhe
- FLUTURA ACADEMY SH.P.K** me seli në Prishtinë, rr. "Vicianum", Objekti C2.7, Arberia 3, Nr. 267, me Numër Unik Identifikues **811411214** të cilin në këtë marrëveshje e përfaqëson pronari z. Fadil Ahmetaj i lindur më 13.10.1991 në Rezallë me nr. personal të letërnjoftimit **1173361552**, përfitues i të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1 Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për një periudhe prej 11 muajsh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, konkretisht objektin e Qendrës së Inovacionit në kuadër të Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)

Neni 2

Kohëzgjatja e Marrveshjes

Palët në marrëveshje janë pajtuar që afati i shfrytëzimit të parcelës të lartcekur të jetë në përputhje me bazën ligjore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, saktësisht 11 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. Pas kalimit të afatit të paraparë në nenin 1 të kësaj Marrëveshje ose ndërprerjës së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Shtime.

Neni 3

Kompensimi

Në mbështetje të nenit 5 [**Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**] të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 1.3 kërkon arsyeshmëri të interesit publik dhe sipas vlerësimeve paraprake, fakti që të rinjve të Komunës do t'u mundësohet përfitimi i shkathtësive digjitale përmes kësaj marrëveshje, Komuna nuk do të kërkojë kompensim monetar nga Flutura Academy Sh.P.K. Formati i dhënes në shfrytëzim me pagesë përveç bazës ligjore të specifikuar vjen edhe si rrjedhojë e nevojës së krijimit të mundësisë për ndjekjen e trajnimeve/kurseve për të rinjtë/femijët që nga klasa e tretë deri në të dyndëdhjetën si dhe krijimi i kushteve dhe mundësive të përgatitjes së të rinjve për tregun e punës me kushte të volitishme dhe shumë profesionale. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nuk mund të ipet në shfrytëzim te personat e tretë nga shfrytëzuesi sipas Marrëveshjes.

Neni 4

Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

Komuna garanton se objekti i kësaj kontrate nuk ka të meta juridike. Shfrytëzuesi nuk mund ta ndryshojë ushtrimin e veprimtarisë së vet, por pronën që e ka marrë në shfrytëzim duhet ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin e kërkuar ashtu siç e ka të paraparë me këtë Marrëveshje.

Neni 5

Mbikëqyrja e Marrëveshjes

Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik dhe pronar i saj mbetet Kuvendi i Komunës së Shtimes, rrjedhimisht si e tillë ajo nuk mund t'i bartet personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetësohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë. Për realizimin e kësaj Marrëveshje palët pajtohen që mbikëqyrëse të jetë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Shtimes.

Neni 6
Pergjegjësitë e dy palëve në
marrëveshje

1. Përgjegjësitë e Komunës së Shtimes:

- Me qëllim të zhvillimit të këtyre aktiviteteve, Komuna e Shtimes ofron në shërbim dhe menaxhim hapësirat e Qendrës së Inovacionit. Komuna e Shtimes do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet komunale si: shpenzimet e energjisë elektrike, mbeturinat, shpenzimet e ngrohjes dhe shpenzimet e ujit.
- Komuna e Shtimes për vitin fiskal 2024 do të ofrojë 60 bursa për nxënësit në vlerë **30 EUR** (gjithsej në total **1,800 EUR**) për 9 muaj sa zgjasin programet, në total **16,200 EUR**.
- Komuna e Shtimes do të transferoj mjetet në gjirologarinë e Flutura Academy.
- Komuna e Shtimes do të caktoj një mbikëqyrës/menaxher të projektit.
- Komuna e Shtimes do të caktoj një anëtarë në Komisionin përzgjedhës të nxënësve.
- Komuna zotohet se do të lejojë organizimin e sesioneve informuese nëpër shkolla në datat e përcaktuara nga Flutura Academy.
- Komuna e Shtimes dhe asnjë autoritet tjetër nuk do të ndërrhyjë në kurrikulat dhe planprogramin e Flutura Academy.
- Komuna e Shtimes dhe asnjë autoritet tjetër nuk do të përdorë këtë projekt për asnjë qëllim politik, si: zhvillim të fushatës apo çfarëdo aktiviteti tjetër që pasqyron promovim politik.
- Komuna e Shtimes do të kujdeset që Flutura Academy do të jetë e pavarur në ushtrimin e veprimtarive të saj sipas kësaj marrëveshje së nënshkruar.

2. Përgjegjësitë e Flutura Academy:

- Flutura Academy do të ofrojë trajnime profesionale dhe të gjuhëve të huaja në fushat si: Programim, Dizajn Grafik, Marketing Digjital, Rrjeta Kompjuterike, Robotikë, Gjuhë Angleze dhe Gjuhë Gjermane.
- Flutura Academy do të ofrojë trajnime duke filluar nga 30 EUR për programet bazike, ndërsa për programet e tjera varësisht tregut dhe nivelit do të përcaktohet edhe çmimi.
- Palët zotohen që bashkërisht do të punojnë në gjetjen e donatorëve të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë për zhvillimin e aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin socioekonomik dhe të ndërmarrësisë.
- Në gjashtëmujorin e parë të funksionimit, Flutura Academy do të ofrojë 90 bursa për nxënësit e Komunës së Shtimes, duke e çuar në 150 nxënës total të përfshirë në trajnimet profesionale, ndërsa, në rast të interesimit dhe nevojës për shtim të kapaciteteve, trajnimet jashtë listës së 150 përsituesve do të jenë me pagesë.

- Flutura Academy do tē mbulojë shpenzimet pér pagat e punonjësve (trajnerëve të programeve), stafit menaxhues dhe stafin mbështetës, i cili do tē përzgjedhet përmes thirrjes së hapur.
- Shpenzimet e internetit dhe shpenzimet e tjera që mund tē dalin si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve jashtëkurrrikulare do tē mbulohen nga Flutura Academy.
- Pajisjet teknologjike (laptopë, televizorë, kompjuterë, printer, skaner, fotokopje) tē nevojshme pér kapacitetin fillestar do tē mbulohen nga Flutura Academy.
- Tē gjitha investimet e nevojshme në objekt pér fillimin e viti akademik do tē mbulohen nga Flutura Academy.
- Aktivitetet rreth fushatave pér informim rreth mundësive pér trajnime, kampanjat dhe puna me grupet punuese në komunitet do tē kryhen nga Flutura Academy.
- Pas përfundimit me sukses tē trajnimeve profesionale, ata tē cilët janë më tē suksesshëm do tē mbështeten mëtutje që tē gjejnë mundësi punësimi në kompani tē fushave tē TIK-ut, veçmas me kompanitë simotra tē Flutura Academy siç janë: Yoloëay, Taktika Studio dhe Treedev.

**Neni 7
Shkëputja e njëanshme e
Marrëveshjes**

Shkëputja e Marrëveshjes në mënyrë tē njëanshme bëhet në rast tē mospërmbushjes së obligimeve nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në dispozitat e kësaj Marrëveshje. Në rast tē shkëputjes së Marrëveshjes para kalimit të afatit, me marrëveshjen e palëve, obligimet e mbeturë do tē rregullohen me marrëveshje tē veçantë mes palëve kontraktuese, por duke e njoftuar njëra-tjetër që dëshiron ta shkëpus marrëveshjen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, para se ta lirojë pronën e marrë në shfrytëzim.

**Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët zotohen se do t'i përbahen kësaj marrëveshje dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj kontrate, tē zgjidhen me anë tē bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në tē kundërten kompetent pér tē vendosur do tē jetë Gjykata kompetente.

**Neni 9
Kopja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje është përpiluar dhe nënshkruar në 5 (pesë) kopje tē njëjta identike prej tē cilave nga 2 (dy) kopje i takojnë secilës palë kontraktuese, kurse një (1) ruhet në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Shtimes.


Nrri 10
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.

PALËT NËNSHKRUESE

Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu



FLUTURA ACADEMY SH.P.K

Fadil Ahmetaj



Pristina 10000,
Republic of Kosovo, Tel: +383 38 606012
flutura@bambusgroup.com | www.flutura-academy.com

Datë: 22.2.2024